

APD:

janar-nëntor 2018, përpunohen mbi 122 mijë kontejnerë TEU

15 dhjetor 2018



Gjatë periudhës janar-nëntor të këtij viti në portin e Durrësit janë përpunuar 122.394 kontejnerë TEU (njësi kontejnerike) gjithsej. Shifra e 11-mujorit të vitit 2018 është 15.731 kontejnerë më e lartë se sa e njejta periudhë e vitit 2017-bën me dije Sektori i Statitikave në APD. Sipas të njejtit burim, numri i kontejnerëve të përpunuar për eksport arrin në 61.030 gjithsej, ndërsa ai i kontejnerëve TEU nga importi arrin shifrën 61.364. Në periudhën janar-nëntor 2018 në kalatën 6 të Terminalit të Kontejnerëve janë përpunuar 167 anije të specializuara. Gjatë së njejtës periudhë në Terminal janë përpunuar afro 1.4 milion ton mallra me kontejnerë gjithsej.